

“C.E.C Group” sh.p.k.

**Pasqyrat Financiare individuale
(Per periudhen 1 Janar -31 Dhjetor 2015)
(ne Leke)**



PERMBAJTJA

Nr.	Emertimi	Faqe
1	Raporti i audituesit te pavarur	
2	Pasqyra e pozicionit financiar	3-4
3	Pasqyra e performances	5
4	Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto	6
5	Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare	7
6	Shenime per pasqyrat financiare	8-14



RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUAR

Drejtuar: Ortakëve të shoqërisë “C.E.C Group” shpk,
Rruga Dritan Hoxha, Ndertesë nr.117, Shkalla nr.2, Apartamenti nr.5/3 ,
Tiranë

Të nderuar Zotërinj,

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë “C.E.C Group” sh.p.k., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 Dhjetor 2015, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, për vitin ushtrimor të përfunduar në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë edhe për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë, është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare, bazuar në procedurat e auditimit. Ne e kemi kryer auditimin, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin, nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare.

Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse të entitetit, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të tij.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmerisë së politikave kontabël të përdorura dhe të aryetueshmërisë së çmuarjeve kontabël të kryera nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të shoqërisë “C.E.C Group” sh.p.k. me datë 31 Dhjetor 2015, performancës së saj financiare dhe flukset e parasë, për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë, në përputhje me Ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar, si dhe parimet bazë e rregullat e parashikuara në “Standartet Kontabël Kombëtare” të përmirësuara.

Venis-Audit & Financë sh.p.k.

Vera Lala
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Tiranë, më 20 Maj 2016



Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)

Nr	A K T I V E T	Shenime	31.12.2015	31.12.2014
	Aktivitet Afatshkurtra			
	▶ Mjetet monetare	1	34,661,301	705,358
	▶ Investime			
	1 Në tituj pronësie të njësiave ekonomike brenda grupit			
	2 Aksionet e veta			
	3 Te tjera Financiare			
	▶ Të drejta të arkëtueshme		2,768,014	4,847,254
	1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit	2	1,195,214	4,675,405
	2 Nga njësitë ekonomike brenda grupit			
	3 Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
	4 Të tjera	3	1,572,800	171,849
	5 Kapital i nënshkruar i papaguar			
	6 Nga te trete			
	▶ Inventarët			
	1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme			
	2 Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte			
	3 Produkte të gatshme			
	4 Mallra			
	5 Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)			
	6 AAGIM të mbajtura për shitje			
	7 Parapagime për inventar			
	▶ Shpenzime të shtyra			
	▶ Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
I	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA		37,429,315	5,552,612
	Aktivitet Afatgjata			
	▶ Aktive financiare			
	1 Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit			
	2 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit			
	3 Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
	4 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
	5 Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata			
	6 Tituj të tjerë të huadhënies			
	▶ Aktivet materiale		17,131,991	2,675,141
	1 Toka dhe ndërtesa	4	12,403,682	
	2 Impiante dhe makineri	4	4,728,309	2,675,141
	3 Të tjera Instalime dhe pajisje			
	4 Parapagime për aktive materiale dhe në proces			
	▶ Aktivet biologjike			
	▶ Aktive jo materiale:			
	1 Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme			
	2 Emri i Mirë			
	3 Parapagime për AAGIM			
	▶ Aktive tatimore të shtyra			
	▶ Kapitali i nënshkruar i papaguar			
II	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		17,131,991	2,675,141
	AKTIVE TOTALE		54,561,306	8,227,753

Keto pasqyra te lexohen sebashku me shenimet shpjeguese F.6-13.

Ekonomist

Orlando Mbuca
OR

Administrator



Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Shenime	31.12.2015	31.12.2014
	▶ Detyrime afatshkurtra:		42,543,968	6,784,826
	1 Titujt e huamarrjes			
	2 Detyrime ndaj institucioneve të kredisë			
	3 Arkëtime në avancë për porosi			
	4 Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	5	40,718,054	6,517,223
	5 Dëftesa të pagueshme			
	6 Të pagueshme ndaj njësiave ekonomike brenda grupit			
	7 Të pagueshme ndaj njësiave ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
	8 Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	6	460,550	59,985
	9 Të pagueshme për detyrimet tatimore (tosh+tatim fitimi)	7	1,365,364	207,618
	▶ Të pagueshme për shpenzime të konstatuara			
	▶ Të ardhura të shtyra			
	▶ Provizione			
	Totali i Detyrimeve afatshkurtera		42,543,968	6,784,826
	▶ Detyrime afatgjata:		6,428,822	973,736
	1 Titujt e huamarrjes			
	2 Detyrime ndaj institucioneve të kredisë			
	3 Arkëtimet në avancë për porosi			
	4 Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit			
	5 Dëftesa të pagueshme			
	6 Të pagueshme ndaj njësiave ekonomike brenda grupit			
	7 Të pagueshme ndaj njësiave ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
	8 Të tjera të pagueshme	8	6,428,822	973,736
	▶ Të pagueshme për shpenzime të konstatuara			
	▶ Të ardhura të shtyra			
	▶ Provizione:			
	1 Provizione për pensionet			
	2 Provizione të tjera			
	▶ Detyrime tatimore të shtyra			
	Totali i Detyrimeve afatgjata		6,428,822	973,736
	DETYRIMET TOTALE		48,972,790	7,758,562
	▶ Kapitali dhe Rezervat			
	▶ Kapitali i Nënshkruar	9	100,000	100,000
	▶ Primi i lidhur me kapitalin			
	▶ Rezerva rivlerësimi			
	▶ Rezerva të tjera			
	1 Rezerva ligjore			
	2 Rezerva statutore			
	3 Rezerva të tjera			
	▶ Fitimi i pashpërndarë		369,191	146,127
	▶ Fitim/ Humbja e Vitit	14	5,119,325	223,064
	Totali i Kapitalit		5,588,516	469,191
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		54,561,306	8,227,753

Keto pasqyra te lexohen sebashku me shenimet shpjeguese F.6-13.

Ekonomist



Administrator



Pasqyra e Performancës
(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Shenime	Viti 2015	Viti 2014
▶	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	10	40,594,262	12,573,604
▶	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces			
▶	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar			
▶	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit			
▶	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-29,994,341	-9,902,897
	1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	11	-29,994,341	-9,902,897
	2 Të tjera shpenzime			
▶	Shpenzime të personelit		-3,721,593	-1,712,887
	1 Paga dhe shpërblime		-3,189,000	-1,341,312
	2 Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)		-532,593	-371,575
▶	Zhvlërësimi i aktiveve afatgjata materiale			
▶	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	4	-928,252	-668,785
▶	Shpenzime të tjera shfrytëzimi			
▶	Të ardhura të tjera		109,718	-26,607
	1 Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)			
	2 Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)			
	3 Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)	12	109,718	-26,607
▶	Zhvlërësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra		0	0
▶	Shpenzime financiare		0	0
	1 Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)			
	2 Shpenzime të tjera financiare			
▶	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
▶	Fitimi/Humbja para tatimit		6,059,794	262,428
▶	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-940,469	-39,364
	1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	13	-940,469	-39,364
	2 Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë			
	3 Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve			
▶	Fitimi/Humbja e vitit	14	5,119,325	223,064
▶	Fitimi/Humbja për:			
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë			
	Interesat jo-kontrolluese			

Keto pasqyra të lexohen sëbashku me shenimet shpjeguese F.6-13.

Ekonomist



Administrator



Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2013	100,000		-1,207,894	1,354,021	246,127	0	246,127
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël					0	0	0
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2014	100,000	0	-1,207,894	1,354,021	246,127	0	246,127
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					0	0	0
Fitimi / Humbja e vitit				223,064	223,064	0	223,064
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					0	0	0
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					0	0	0
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:					0	0	0
Emetimi i kapitalit të nënshkruar					0	0	0
Dividendë të paguar					0	0	0
Caktimi i fitimit			1354021	-1354021	0	0	0
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike					0	0	0
					0	0	0
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014	100,000	0	146,127	223,064	469,191	0	469,191
					0	0	0
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015	100,000	0	146,127	223,064	469,191	0	469,191
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					0	0	0
Fitimi / Humbja e vitit				5,119,325	5,119,325	0	5,119,325
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					0	0	0
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					0	0	0
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:					0	0	0
Emetimi i kapitalit të nënshkruar					0	0	0
Dividendë të paguar					0	0	0
Caktimi i fitimit			223064	-223064			
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-		0	0	0
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	100,000	-	369,191	5,119,325	5,588,516	-	5,588,516

Keto pasqyra te lexohen sebashku me shenimet shpjeguese F.6-13.

Ekonomist

Administrator



Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare
(metoda indirekte)

	2015	2014
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
<i>Fitim / Humbja e vitit</i>	5,119,325	223,064
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
<i>Shpenzimet financiare jomonetare</i>	1,022	60,635
<i>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar</i>	940,469	39,364
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	928,252	668,785
<i>Te tjera jomonetare</i>		
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	706,440	-3,032,730
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>		
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	35,358,577	3,825,641
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>	400,565	-662
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	43,454,650	1,784,097
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
<i>Para neto të përdorura për blerjen e filialeve</i>		
<i>Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve</i>		
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	-7,034,360	0
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>		
<i>Pagesa për blerjen e investimeve të tjera</i>		
<i>Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera</i>		
<i>Dividendë të arkëtuar</i>		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-7,034,360	0
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
<i>Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>		
<i>Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
<i>Hua të arkëtuara</i>		
<i>Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë</i>		
<i>Riblerje e aksioneve të veta</i>		
<i>Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
<i>Pagesa e huave</i>	-2,464,281	-1,734,664
<i>Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare</i>		
<i>Interes i paguar</i>		
<i>Dividendë të paguar</i>		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-2,464,281	-1,734,664
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	33,956,009	49,433
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	705,358	655,925
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	66	0
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	34,661,301	705,358

Keto pasqyra te lexohen sebashku me shenimet shpjeguese F.6-13.

Ekonomist



F.7



“C.E.C Group” sh.p.k.

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE
per periudhen 1 Janar -31 Dhjetor 2015 (ne Leke)

a).INFORMACIONE TE PERGJITHESHME

Shoqeria “C.E.C Group” sh.p.k eshte themeluar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me date 03.06.2011 dhe eshte rregjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me date 07.06.2011, me numer unik te identifikimit L11807013M.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, nga statuti dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi per tatimet dhe taksat.

Objekti i veprimtarise: Studim - Projektim, Supervizion, Mbikqyrje - Kolaudim, Konsulence Teknike. Studim, projektim, mbikqyrje, kolaudim per ndertim e zbatim te veprave ndertimore te te gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar. Studime urbanistike te te gjitha llojeve.

Kapitali : 100,000 leke

Kuotat e pronesisë: Z. Vangjush Mbricë, zoterues 51 kuotave , qe perben 51 % te kapitalit te regjistruar.
Z. Anduen Mbricë, zoterues 49 kuotave , qe perben 49 % te kapitalit te regjistruar.

Administrator: Z. Vangjush Mbricë me te drejta dhe detyra te percaktuara ne statutin e shoqerise, me afat emerimi deri 20.02.2020.

Adresa e selise : Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Dritan Hoxha, Ndertesa nr.117, Shkalla nr.2, Apartamenti nr.5/3 ,Tirane.Shoqeria kryen aktivitetin ne ambientet prone e saj.

Numri i punonjesve me date 31 Dhjetor 2015 ishte 15 punonjes.

b).PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL

Bazat per pergatitjen e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne te gjitha aspektet materiale, duke respektuar kerkesat e parashikuara ne Ligjin nr. 9228 date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” te ndryshuar si dhe parimet baze e rregullat e parashikuara ne Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar (SKK).

Per zbatimin e politikave kontabel per vleresimet si dhe per te tjera elemente te nevojshem per pergatitjen e pasqyrave financiare (PF) te vitit 2015, jemi referuar tek SKK nr.1- “Kudri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare”. Politikat kontabel janë parimet specifike, bazat, konvencionet, rregullat dhe praktiket e zbatuara nga një njësi ekonomike në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Pasi përzgjidhet një politikë kontabel, ajo zbatohet në mënyrë të qëndrueshme vit pas viti. Politika kontabel mund të ndryshojë ne raste specifike, te parashikuara ne SKK.

Lista e llogarive e perdorur per mbajtjen e regjistrimeve kontabel, eshte ajo e shpallur nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit.

Pasqyra e Pozicionit Financiar, Pasqyra e Performancës, Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare dhe Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto, jane paraqitur sipas formatit te parashikuar ne SKK-2 të përmirësuar. Informacioni per gjendjen me date 31.12.2015 eshte plotesisht i krahasueshem per cdo element te PF. Ne shenimet shpjeguese jane paraqitur vlerat analitike per cdonjerin prej tyre.

Sipas parimeve te kontabilitetit te pranuar gjeresisht ne Shqiperi, deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit materialitetit, te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara, te parimit te vijimesise etj. sipas SKK 1.



Bazat e përgatitjes

Disa të dhëna financiare, të paraqitura në pasqyrat financiare, bazohen në vlerësime të bëra nga drejtuesit e njësisë ekonomike, dhe jo në fakte të vëzhguara në mënyrë objektive. Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabël janë:

- (a) vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve;
- (b) vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, si dhe përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit;
- (c) krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Vlerat në pasqyrat financiare janë shprehur në monedhen kombëtare LEKE.

Bazat e matjeve

Në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet kontabël që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjendjen financiare, rezultatit financiar dhe flukset e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës (të drejtat dhe detyrimet e konstatuara). Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, bëhet me koston historike, përveç rasteve kur SKK 1, kërkon matje fillestare mbi një bazë tjetër të tillë si vlera e drejtë. Vlerësimi i mëpasshëm i aktiveve dhe detyrimeve financiare bëhet me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, sikurse përcaktohet në SKK 3, ndërsa të aktivet dhe pasivet e tjera duhet të referohemi rast pas rasti SKK-ve përkatëse.

Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e pasiveve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike raportuese, duke përjashtuar këtu ato që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga njësia ekonomike për llogari të vet. Shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Për këtë arsye ato nuk përfshihen në të ardhura.

Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejtë të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të kompanisë.

Në lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat janë njohur kur ndryshimi i pronësive se bashku me riskun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi.

Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat përkatëse. Shpenzimet e kryera gjatë një periudhe raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njësisë ekonomike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht në periudhën kur merren përfitimet. Shpenzimet e ndodhura, për të cilat njësia ekonomike nuk prë të ardhshme, njihen menjëherë në rezultatit financiar.

Aktivitet monetare

Në këtë grup përfshihen mjetet monetare gjendje në datë 31.12.2015 në llogaritë rrjedhëse pranë bankave të nivelit të dytë si dhe në arke. Për njohjen fillestare të këtyre elementeve si dhe për gjendjet, është përdorur politika kontabël e vlerës nominale.

Të drejta të arkëtueshme

Në këtë grup janë përfshirë kërkesat të arkëtueshme nga klientët nga aktiviteti i shfrytëzimit, si dhe kërkesat të tjera debitore, të cilat janë vlerësuar me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm (nëse ka).

Detyrime të pagueshme

Në këtë grup janë përfshirë detyrimet e pagueshme ndaj institucioneve të kredise, furnitoreve, punonjësve, ortakëve për dividende dhe hua, kreditorëve të tjerë, etj. Në njohjen fillestare zerat e këtij grupi janë vlerësuar me kosto. Në fund të vitit detyrimet vlerësohen me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.



“C.E.C Group” sh.p.k.

Parimisht, ne vijim te njohjes fillestare, huate dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur cdo diference midis koston dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interesi efektiv.

Detyrime tatimore

Ne kete grup perfshihen te gjitha llojet e tatimeve e taksave, te llogaritura e te papaguara ndaj administrates tatimore, te cilat vleresohen me vlere nominale. Detyrimet tatimore afatshkurtra dhe afatgjata nuk skontohehen dhe nuk zhvleresohen.

Inventaret

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare te tyre shoqeria vlereson inventarin me vleren me te ulet midis koston dhe cmimit te mundshem te shitjes minus koston e transaksionit te shitjes. Cmimi i mundshem i shitjes i referohet vleres neto qe njësia ekonomike raportuese pret te perfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventaret i nenshtrohen testit te zhvleresimit ne daten e mbylljes se bilancit. Shuma e Zhvleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve atehere kur ka faktore te objektive qe tregojne qe inventaret jane zhvleresuar.

Metoda e perdorur nga shoqeria per llogaritjen e koston se stokut eshte metoda e mesatares se ponderuar.

Aktive afatgjata materiale (AAM)

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi (nuk ka patur humbje nga zhvleresimi).

Ne kete grup jane paraqitur gjendjet e aktiveve afatgjata materiale qe perbehen nga ndertesa, mjete transporti, makineri e vegla pune, pajisje informatike si dhe mobilje e pajisje zyre. Aktivet Afatgjata Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivitetit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.

Metoda per llogaritjen e amortizimit per te gjitha AAM e shoqerise, eshte metoda e vleres se mbetur, e percaktuar ne Ligjin nr. 8438 date 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" te ndryshuar .

Normat vjetore te amortizimit te aplikuar jane si më poshtë vijon:

Pershkrimi	Norma vjetore	Metoda
Ndertese	5%	Me vlere e mbetur
Mjet transporti	20%	Me vlere e mbetur
Makineri e vegla pune	20%	Me vlere e mbetur
Pajisje informatike	25%	Me vlere e mbetur
Mobilje e orendi	20%	Me vlere e mbetur

Parapagime , shpenzime te shtyra dhe

Aktivitetet e njohura si Parapagime dhe shpenzime te shtyra paraqiten ne pasqyrat financiare me Vleren nominale te shumes se parapaguar.

Shpenzime te konstatuara dhe te ardhura te shtyra

Detyrimet per shpenzime te konstatuara paraqiten me Vleren nominale te shumes per tu paguar, ndersa detyrimet per te ardhurat e shtyra paraqiten ne pasqyrat financiare me kosto te amortizuar.

Kapitali

Kapitali i shoqerise eshte perbehet nga kuotat e kapitalit, te cilat jane njohur me vleren nominale, sikurse percaktohet ne statutin e shoqerise.

Te ardhura te tjera dhe shpenzime financiare

Te ardhurat e tjera permbledhin te ardhurat nga njësitet ekonomike ku ka interesa pjesemarrëse, te ardhurat nga interesi, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje dhe e aktiveve afatgjata materiale, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.



“C.E.C Group” sh.p.k.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet e aktiveve financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodës se interesit efektiv.

Tatimi mbi të ardhurat

Shpenzimi (e ardhura) tatimor është shuma totale që i zbritet (shtohet) fitimit (humbjes) kontabël për përcaktimin e fitimit ose humbjes neto të periudhës kontabël, dhe përbëhet nga shpenzimi (e ardhura) tatimor aktual dhe shpenzimi (e ardhura) tatimor i shtyrë.

Tatimi aktual është shuma e tatimit mbi fitimin, e pagueshme (e zbritshme) mbi fitimin (humbjen) e tatueshëm të periudhës kontabël aktuale. Tatim fitimi është llogaritur ne perputhje me kerkesat e ligjit nr. 8438 date 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" te ndryshuar. Tatim fitimi është llogaritur ne masen 15% te te ardhurave te tatueshme.

Tatimi i shtyrë është tatimi i pagueshëm (i zbritshëm) në periudhat e ardhshme, zakonisht si rezultat i realizimit të aktiveve ose shlyerjes së detyrimeve nga njësia ekonomike me vlerën e tyre aktuale kontabël, dhe efekti tatimor i mbartjes së humbjeve tatimore dhe i tatimeve të zbritshme

Transaksionet ne valute te huaj

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit.

Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit te perdorura per vleresimin e gjendjeve ne valute me date 31.12.2015 dhe 31.12.2014 jane:

Monedha	31. DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
EUR	137.28	140.14
USD	125.79	115.23

c).SHENIME SHPJEGUESE

Aktivet Afatshkurtra

1. Aktivet monetare

Likuiditete dhe vlera arke te tjera	31.12.2015	31.12.2014
Llogari ne banke	34,512,324	704,345
Llogari rrjedhese ne LEK	34,501,538	703,785
Llogari rrjedhese ne EUR	10,786	561
Para ne dore	148,977	1,013
Ne monedhe vendase	148,977	1,013
Total mjete monetare	34,661,301	705,358

Vlera e mesiperme perfaqeson totalisht vleren e likuiditeteve me date 31.12.2015 gjendje ne llogarite qe shoqeria ka prane bankave te nivelit te dyte ne leke dhe valute si dhe gjendjen e arkes. Gjendja e likuiditeteve (ne banke) e paraqitur ne bilanc rakordon me shumën e ekstrakteve të bankes.

2. Të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

Emertimi	31.12.2015	31.12.2014
Kliente per sherbime	1,195,214	4,675,405
TOTAL	1,195,214	4,675,405



“C.E.C Group” sh.p.k.

Ne kete rubrike jane paraqitur vlerat per t'u arketuar nga klientet si ne tabelen bashkelidhur.

3. Të drejta të tjera

Emertimi	31.12.2015	31.12.2014
Bashkia Tirane	200,000	0
Debitore te tjere	1,372,800	0
Shteti -Tatim Fitimi	0	171,849
TOTAL	1,572,800	171,849

Ne kete rubrike jane paraqitur vlerat per t'u arketuar nga Bashkia Tirane, per gjobe te paguar 2 here, nga debitore te tjere per hua afatshkurtra. Ne lidhje me tatim fitimin sqarojme se balance e mbartur nga viti 2014 ne vend te shumes 171,849 leke (sikurse ishte ne balancen e celjes), duhej 289,594 leke, vlere e cila eshte saktësuar ne vitin 2015.

4. Aktivet materiale

Aktive Afatgjata Materiale	Ndertesat	Mjete Transporti	Pajisje etj AAM	Totali
Gjendje 01.01.2015	0	3,138,463	205,463	3,343,926
Shtesa	12,507,915	1,330,000	1,547,187	15,385,102
Pakesime				0
Gjendje 31.12.2015	12,507,915	4,468,463	1,752,650	18,729,028
Amortizimi				
Gjendje 01.01.2015	0	-627,693	-41,093	-668,785
Shtesa	-104,233	-612,987	-211,032	-928,252
Pakesime				0
Gjendje 31.12.2015	-104,233	-1,240,680	-252,125	-1,597,037
Vlera neto 01.01.2015	0	2,510,771	164,371	2,675,141
Vlera neto 31.12.2015	12,403,682	3,227,784	1,500,526	17,131,991

Aktivitet afatgjata materiale jane prone e shoqerise, me perjashtim te ndertesat, e cila eshte perfshire ne inventar referuar kontrates se premtim shitjes nr.3889 Rep, 2249 Kol, date 08.10.2015 dhe procesverbalit te marrjes ne dorezim date 10.10.2015, per te cilen akoma nuk eshte marre çertifikata e pronesisë. Aktivitet e tjera jane dokumentuar ne menyre te rregullt dhe priten perfitime ekonomike ne te ardhmen.

5. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Emertimi	31.12.2015	31.12.2014
Furnitore te ndryshem	40,718,054	6,517,223
TOTAL	40,718,054	6,517,223

Kjo vlere perfaqeson detyrimet ndaj furnitoreve per tu paguar pas dates 31.12.15, pjese e veprimtarise se shfrytezimit te shoqerise sone.

6. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve	31.12.2015	31.12.2014
Paga	361,226	0
Sigurime Shoqerore dhe te Ngjashme	99,324	59,985
TOTAL	460,550	59,985



“C.E.C Group” sh.p.k.

Eshte detyrimi qe ka shoqeria per te paguar vleren e mesiperme per pagat e punonjesve dhe te kontributeve per sigurime te muajit dhjetor 2015 te cilat jane paguar ne janar 2016.

7. Të pagueshme për detyrimet tatimore	31.12.2015	31.12.2014
Shëqiti - Tatim mbi paga	1,950	1,040
Shteti - TVSh	810,176	206,578
Shteti - tatim fitimi	553,238	0
TOTAL	1,365,364	207,618

Per llogaritjen e detyrimeve tatimore shoqeria ka mbajtur parasysh kerkesat e Ligjit “Per Sigurimet shoqerore dhe shendetesore”, per “Tatimin mbi te ardhurat”, per Tvsh-ne, etj, te zbatueshme per aktivitetin e shoqerise tone. Detyrimet tatimore te papaguara me date 31.12.2015 sipas natyres dhe vlerat perkatese jane paraqitur ne tabelen e sipershenuar. Sipas FDP Dhjetor 2015 detyrimi i shoqerise per tvsh ishte 736,908 leke, diferenca 73,268 leke perfaqeson detyrim shtese nga sistemimit e tvsh per vitin 2015. Po keshtu detyrimi per tatim fitimin e vitit 2015 nga 773,442 leke qe ishte deklaruar, duhet 940,469 leke, duke gjeneruar nje detyrim shtese per tu paguar prej 167,027 leke.

8. Të pagueshme ndaj ortakeve

Emertimi	31.12.2015	31.12.2014
Hua nga ortakut	6,428,822	973,736
TOTAL	6,428,822	973,736

Ne kete rubrike jane paraqitur detyrimet e shoqerise ndaj ortakeve per shumen 46,830 eur, parapaguar ne emrin e tij per blerje te nderteses se zyrove, kontrate e cila me date 08.10.2015 eshte transferuar nga individi tek shoqeria «C.E.C Group» shpk. Si rezultat shoqeria ka njohur detyrimin ndaj individit per kete vlere (per me teper shih shenimin nr.4).

9. Kapitali

Emertimi	31.12.2015	31.12.2014
Vangjush Mbricë	51,000	51,000
Anduen Mbricë	49,000	49,000
TOTAL	100,000	100,000

Gjendja e kapitalit me date 31.12.2015 dhe 31.12.2014 ishte si me lart, pra nuk ka patur ndryshime ne kapitalin e shoqerise.

10. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

	31.12.2015	31.12.2014
Te ardhura nga sherbimet	40,594,262	12,573,604
TOTAL	40,594,262	12,573,604

Ne kete rubrike jane paraqitur te ardhurat nga veprimtaria kryesore qe eshte dhena e sherbimeve te studimit, projektimit, mbikqyrjes, kolaudimit dhe konsulences per ndertim e zbatim te veprave ndertimore te te gjitha llojeve, e cila eshte trajtuar si shitje e tatueshme me tvsh.

11. Shpenzime të tjera shfrytëzimi



“C.E.C Group” sh.p.k.

Emertimi	31.12.2015	31.12.2014
blerje sherbimesh per rishitje	27,576,030	8,494,225
Shpenzime te tjera administrative	2,418,311	1,408,672
TOTAL	29,994,341	9,902,897

12. Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme

	31.12.2015	31.12.2014
Te ardhura nga veprimet valutore	49,050	0
Humbje nga veprimet valutore	0	-26,607
Te ardhura nga interesa	1,668	0
Te ardhura te tjera financiare	59,000	0
TOTAL	109,718	-26,607

13. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

	31.12.2015	31.12.2014
Total te ardhura	40,703,981	12,573,604
Total shpenzime	-34,644,187	-12,311,176
Fitimi para tatimit	6,059,794	262,428
Shpenzime te pazbritshme	210,000	0
Gjobe	210,000	0
Fitimi tatimor i ushtrimit/ Humbje	6,269,794	262,428
Humbje te mbartura	0	0
Fitimi i tatueshem i ushtrimit	6,269,794	262,428
Tatim fitimi 15%	-940,469	-39,364

Tatim fitimi i llogaritur per vitin 2015 eshte 940,469 leke, i cili krahasuar me vleren e mbipaguar deri me 31.12.2014 prej 289,594 leke dhe me parapagimet e kryera gjate vitit 2015 me vlere 97,637 Leke, gjeneron detyrimin ndaj shtetit me vlere 553,238 leke, vlere e cila eshte paraqitur ne shenimin nr.7 te pasqyrave financiare.

26. Palet e lidhura

Gjate vitit 2015 shoqeria ka kryer transaksione me palet e lidhura per financime,qera dhe paga.

27. Ngjarjet pas dates se bilancit

Deri ne date 20.04.2016, date ne te cilen ka perfunduar mbyllja e pasqyrave financiare te vitit 2015, nuk ka patur ngjarje materiale, te cilat te jepnin efektin e tyre ne gjendjen dhe rezultatin e raportuar per periudhat ushtrimore te meparshme.

Pasqyrat financiare jane autorizuar nga administrator i shoqerise me date 20 Prill 2016.

Financier



Tirane, me 20 Prill 2016

Vangjush Mbrice

Administrator

